



Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A
Bordi i Drejtorëve

Nr. III/23
Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të Nenit 34 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 15 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A, në Mbledhjen Nr. 38, të datës 30.03.2022 nxori këtë:

VENDIM

Për pezullimin e përkohshëm të zbritjeve tarifore të përcaktuara në Rregulloren mbi Përcaktimin e Kriteve për Kontratë dhe Kushtet e Transportit të Mallrave Nr. 2/133, datë 30.12.2016:

- I. Pezulohen zbritjet tarifore të përcaktuara në nenin 4.1:
 - a. Zbritja e tarifave për bllok tren prej 20 %;
 - b. Zbritja e tarifave për bllok tren për vagonë privat "P" prej 10 %.
- II. Pezulohen zbritjet tarifore të transportit të mallrave me tren marshutë me vagon privat "P" prej 20 % të përcaktuara në nenin 4.4, pika b.
- III. Pezulohen zbritjet tarifore të lejuara nga Kryeshefi Ekzekutiv me vendim të menaxhmentit deri në 20 % të përcaktuara në nenin 8.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Për Bordin e Drejtorëve

Ramush AHMETAJ - Kryesues

I dërgohet:

- Menaxhmentit të HK-Trainkos Sh.A
- Aksionarit – NJPMNP
- Arkivit